



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 2743 Prot.

Patos më, 12/09/2025

Miratohet
Kryetari
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 55, datë 12.09.2025

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIM I PAKETËS SË SHTRESAVE ASFALTIKE NË RRUGËT “HERONJTË E LINASIT”, “SHPIRAGU” DHE DEGËZIM I RRUGËS “SULO GOXHAJ”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, V.K.B nr. 87, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025”, V.K.B nr. 40, datë 18.06.2025 “Për miratimin e tavaneve përfundimtar të programit buxhetor 2026-2028”, Ekipi i programit të menaxhimit rrugë rurale për të vazhduar me procedurat e mëtejshme të implementimit të projektit,

KËRKON:

1. Miratimin e zbatimit të projektit “Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët “Heronjtë e Linasit”, “Shpiragu” dhe Degëzim i rrugës “Sulo Goxhaj” me vlerë 17,249,728.97 Lekë (duke përfshirë shërbimin e mbikqyrjes+kolaudimin).
2. Fondi për realizimin e projektit do të mbulohet brenda programit Rrugë Rurale nga rishpërndarja e fondeve përgjatë dy viteve si më poshtë:
 - a. Fondi për vitin 2025: 7,700,000 Lekë
 - b. Fondi për vitin 2026: 9,900,000 Lekë

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË RRJETIT RRUGOR RURAL
DREJTUES I PROGRAMIT**

Ermenita MICI

Anëtarët e Programit

Sokol META

Arben SEMANJAKU

Juela SHPATA

Çajup REFITAJ

Iris XHELAJ

Boreta MURATI

Juriste

Nurkë HAZIZAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E PATOS

Nr. 2743 / Prot.
11

Patos më, 12/09/2025

RELACION PËR PROJEKTVENDIM

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT “PËRMIRËSIM I PAKETËS SË SHITESAVE ASFALTIKE NË RRUGËT “HERONJTË E LINASIT”, “SHPIRAGU” DHE DEGËZIM I RRUGËS “SULO GOXHAI””

Bashkia e Patos ka miratuar me VKB nr. 87 datë 19.12.2024, buxhetin për vitin 2025. Nga vlerësimi i ecursionit të investimeve gjatë kësaj periudhe, për objektet e pa realizuara deri në këtë fazë të përfshira në buxhetin e vitit 2025-2026 është parashikuar një rishpërndarje e fondeve në programin rrugë rurale, me qëllim dhënien e prioritetit realizimit të projektit për përmirësimin e paketës së shtresave asfaltike në disa rrugë të qytetit, duke përmirësuar shërbimin e transportit në bashkinë Patos dhe ofrimin e shërbimeve të munguara për qytetarët.

Grupi i projektimit nga drejtoria e projekteve dhe emergjencave civile ka analizuar gjendjen aktuale dhe ka vlerësuar të domosdoshme ndërhyrjen në paketën e shtresave rrugore. Kjo për arsye se kemi të bëjmë me rrugë që ndodhen në zonë urbane, të cilat kanë një fluks të lartë qarkullimi. Nga ana tjetër këto rrugë shërbejnë për lëvizjen e banorëve të zonës, të cilët kanë adresuar kërkesa të vazhdueshme për të ndërhyrë në këto segmente. Projekti parashikon ndërhyrjet si më poshtë:

1. Në rrugën “Heronjtë e Linasit” do të realizohet skarifikimi i shtresave ekzistuese, të cilat janë dëmtuar me kalimin e viteve dhe do të plotësohen me shtresë binder $t=5\text{cm}$ dhe shtresë asfaltobeton $t=4\text{cm}$. Rruga ka një gjatësi $L=425\text{m}$, $b=5.20\text{m}$.
2. Në rrugën “Shpiragu” është parashikuar ndërhyrje për plotësimin e rrugës me shtresat e nevojshme në një gjatësi $L=150\text{m}$, $b=3.50\text{m}$, duke parashikuar sistemimin e zonës, lirin e hapësirave publike, krijimin e kushteve për qarkullimin e këmbësorëve, makinave dhe hapësirat e nevojshme për parkim.
3. Degëzimi i rrugës “Sulo Goxhaj” është rruga në sheshin midis pallateve në lagjen “Naftëtari” e cila parashikon një rehabilitim total të zonës ku pjesë e projektit është shtrimi i rrugës duke mundësuar kalimin e makinave dhe hapësira të nevojshme për parkim për banorët e lagjes.

Referuar situatës së mësipërme ndërhyrja për rikonstrukcionin e këtyre rrugëve shikohet si një domosdoshmëri për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme për të gjithë zonën.

Bashkia Patos ka hartuar projektin e rikonstrukcionit e këtyre rrugëve, ku përfshihet rehabilitimi i karrexhatës me paketën e shtresave të nevojshme. Vlera e projektit është 17,249,728.97 lekë me tvsh e cila do të mbulohet brenda programit rrugë rurale. Kjo vlerë përfshin dhe realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe kolaudimit.

Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e zbatimit të projektit “Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët “Heronjtë e Linasit”, “Shpiragu” dhe Degëzim i rrugës “Sulo Goxhaj”” me vlerë 17,249,728.97 Lekë (duke përfshirë shërbimin e mbikqyrjes+kolaudimin).
2. Fondi për realizimin e projektit do të mbulohet brenda programit Rrugë Rurale nga rishpërndarja e fondeve përgjatë dy viteve si më poshtë:
 - a. Fondi për vitin 2025: 7,700,000 Lekë të cilat:
 - 6,500,000 lekë pakësim objekti “Ndërtim i kuartallit të ri në varrezat e qytetit”.
 - 900,000 lekë çlirim nga objekti “Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme të bllokut Vresht”.
 - 300,000 lekë çlirim nga objekti “Rikonstrukcioni i rruges Industriale, kryqezimi ku bashkohet me rrugen Franc Nopce”.
 - b. Fondi për vitin 2026: 9,900,000 Lekë
3. Për ndjekjen e zbatimit e projektvendimit ngarkohet drejtoria e projekteve dhe emergjencave civile, drejtoria e financës, sektori i prokurimeve dhe drejtoria e planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve.

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË RRJETIT RRUGOR RURAL
DREJTUES I PROGRAMIT**

Ermenita MICI

Anëtarët e Programit

Sokol ~~META~~

Arben SEMANJAKU

Juela SHPATA

Çajup REFITAJ

Iris XHELAJ

Boreta MURATI

KRYETARI

Fation Duro